



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:176857

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624193

PKR.nr.295/21

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri, në çështjen penale kundër të pandehurve Sh. M., D. L., U. V., Sh. C. dhe J. G., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219, paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me shenjë PP./I.nr.509/2020, të datës 19.05.2021, duke vendosur lidhur me kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesave për hudhjen e aktakuzës, të parashtruara nga mbrojtësit e të pandehurve: A. P., H. P., L. V., I. C. dhe F. G. – B., që të gjithë avokat në Prishtinë, si dhe përgjigjes së Prokurorit të shtetit, jashtë seancës, me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e evidentuar me shenjë PP./I.nr.509/2020, e datës 19.05.2021 dhe PUSHOHET procedura penale, për veprën penale në bashkëkryerje Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219, paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurve si në vijim:

1. SH. M., nga i ati Xh. dhe e ëma H. (e vajzërisë Sh.), i lindur me datë ... në fshatin H., Komuna e O., tani me vendqëndrim në P., rruga “U.” ... numër ..., me numër personal të ID-së ..., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme - juridik, pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. D. L., nga i ati I. dhe e ëma A. (e vajzërisë Z.), i lindur me datë ... në P., ku edhe jeton rruga “P. i N.”, pa numër, me numër personal të ID-së ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion Kamarier, me punësim te përkohshëm ne Gj., i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.
3. U. V., nga i ati A. dhe e ëma B. (e vajzërisë B.), i lindur me datë .. në P., ku edhe jeton, rruga “Xh. M.” numër .., me numër personal të identifikimit ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion I. i rrjetave, i punësuar në kompaninë amerikane “N.”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.
4. SH. C., nga i ati M. dhe e ëma R. (e vajzërisë E.), i lindur me datë ... në P., ku edhe jeton, rruga “N. K.” numër .., me numër personal të identifikimit ..., i martuar, baba i një (1) fëmiu, ka të kryer shkollën e mesme, punon në ndërtimtari – punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.
5. J. G., nga i ati A. dhe e ëma Z. (e vajzërisë B.), e lindur me datë ... në P..., rruga “V..” numër .., T..., tani me vendqëndrim në V., të SH..., me numër personal të identifikimit ....., e pa martuar, ka të përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, tani në studime post diplomike në SH..., e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

II. Për shkak se Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza.

III. I dëmtuari K. Q. i Z. në P., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

IV. Shpenzimet e procedurës penale – paushallit gjyqësor, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti për Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzën e evidentuar me shenjë PP./I.nr.509/2020, të datës 19.05.2021, kundër të pandehurve Sh. M., D.L., U. V., Sh. C. dhe J. G., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219, paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me datë 15.03.2024, ka treguar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale ku kanë prezantuar Prokurorja e shtetit B. Gj., i pandehuri Sh. M. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat A. P., i pandehuri D. L. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare H. P., i pandehuri U.V. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit L. V., i pandehuri Sh. C. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat H.C., dhe e pandehura J. G. me mbrojtësen e saj sipas autorizimit avokate F. G. – B., ndërsa ka munguar përfaqësuesja nga i dëmtuari K.Q.Z.

Në shqyrtimin fillestar të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila iu është vënë në barrë, për çka gjykata konform nenit 240 paragrafi 7 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPPRK), të njëjtit janë njoftuar që në afatin prej (15) ditëve, mund të paraqesin çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të KPPRK-së, si dhe çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës bazuar në nenin 244 paragrafit 1 të KPPRK-së.

Mbrojtësit e të pandehurve, A.P., H. P., L. V., H. C. dhe F. G. – B., që të gjithë avokat në P., brenda afatit ligjor, kanë parashtruar kundërshtim të provave dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës,

Prokuroria e shtetit brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje lidhur me kërkesat e mbrojtësve të të pandehurve, në raport me kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohen si të bazuara të njëjtat duke konsideruar se kërkesat në fjalë janë të bazuara duke pasur parasysh dashjen si element parësor i kryerjes së veprës penale, për çka edhe është tërhek nga ndjekja penale kundër të pandehurve të cekur në aktakuzën PP.I.nr.509/20.

Andaj, gjykata duke u bazuar në përgjigjen e parashtruar si më sipër nga prokurori i shtetit, nuk është lëshuar në pretendimet e parashtruara nga ana e mbrojtësve të të pandehurve, në raport me kërkesat për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës, për çka edhe e ka hudhur

aktakuzën dhe e ka pushuar procedurën penale bazuar në nenin 248 të KPPRK-së, e cila ka përcaktuar *Hedhjen e Aktakuzës dhe Pushimin e Procedurës*, përkatësisht paragrafi 1 dhe 3 i nenit në fjalë ka paraparë se: *“Për çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se: 1.1. vepra me të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale; 1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; 1.4. i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata; 1.5. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë; 1.6. aktakuza nuk është ngritur brenda afatit të paraparë në nenin 234 të këtij Kodi; ose Në përgjigjen ndaj kërkesës nga neni 244 i këtij Kodi, prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga aktakuza nëse kërkesa është e bazuar”.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko-civil, u muar në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPPRK-së.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.295/21, datë 26.04.2024

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,

Gazmend Bahtiri

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej dhjetë (10) ditëve, nga momenti i pranimi të aktvendimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.